



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1198/Prot.
14

Tiranë më 25.5.2021

VENDIM

Nr. 02, datë 24.05 2021

**“MBI MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE TË SEMESTRIT TË DYTË NË
UNIVERSITETIN E TIRANËS”**

Në mbledhjen e datës 24/05/2021, Rektorati i Universitetit të Tiranës, bazuar në nenin 40, pika 4 të Ligjit 80/2015; neni 36, pika 3 dhe 4 të Statutit të UT-së, si dhe Urdhrin nr. 89, datë 10.05.2021 të Ministres së Arsimit Sportit dhe Rinisë “Për marrjen e masave për mbarimin e vitit akademik 2020-2021 nga institucionet e arsimit të lartë”,

VENDOSI:

1. Provimet e semestrit të dytë do të zhvillohen online.
2. Provimet të cilat për shkak të specifikës së lëndës do të zhvillohen në auditor, duhet të miratohen paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë pas kërkesës së titullarit të lëndës.
3. Për këto lëndë, duhet të parashikohet dhe një datë për zhvillimin e provimeve online për të mos penalizuar studentët të cilët për arsye objektive e kanë të pamundur për t’u paraqitur në auditor ose të përcaktohet një periudhë e mëvonshme e zhvillimit të tyre brenda muajit korrik.
4. Personeli akademik që do të zhvillojë provimin në auditor është përgjegjës për zbatimin e Rregullores së Universitetit të Tiranës “Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi COVID -19”.
5. Ky vendim u përcillet për zbatim të gjitha njësive përbërëse të UT-së.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
PROF. DR. ARTAN HOXHA